



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-046
Prishtinë, më 29 tetor 2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 29 TETOR 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufera Srbica-Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Armend Zemaj, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër (4) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit,
2. Kërkesë e 42 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjimit të kufijve” në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë,
3. Caktimi i datës për vazhdimin e seancave plenare të papërfunduara, më 13, 14, 20 shtator, më 15, 18, 19 dhe 25 tetor 2018,
4. Përgatitjet për seancë plenare të radhës,
5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15 tetor 2018.

2. Kërkesë e 42 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjimit të kufijve” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë

Kryetari i njoftoi të pranishmit se 42 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit për datën 1 nëntor 2018, për debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjimit të kufijve” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Deputeti Armend Zemaj, në emër të propozuesit të kërkesës për seancë të jashtëzakonshme, propozoi që seanca e jashtëzakonshme të mbahet të mërkurën, më 31 tetor 2018, në orën 10:00. Diskutimi i plotë i z. Zemaj është dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar për seancë të jashtëzakonshme diskutuan: kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli dhe nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, me pëlqimin e propozuesit dhe të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme të mërkurën, më 31 tetor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

3. Caktimi i datës për vazhdimin e seancave plenare, të mbajtura më 13, 14, 20 shtator dhe 15, 18, 19 dhe 25 tetor 2018

Kryetari i njoftoi të pranishmit lidhur me pikat e papërfunduar nga seancat plenare të mbajtura më 13, 14, 20 shtator, me 15, 18, 19 dhe 25 tetor 2018.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me caktimin e datës për vazhdimin e seancave të papërfunduara.

Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit me pikat e papërfunduara më 13, 14, 20 shtator, më 15, 18, 19 dhe 25 tetor 2018, më 31 tetor 2018, në orën 14:00, me këtë:

Rend dite

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë,

2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,

3. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës,

4. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor,

5. Votimi për shkarkimin e z. Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për referendum,

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private,

11. Votimi në parim i Projektligjit për transmetuesin publik të Kosovës,

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë,

13. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,*
14. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,*
15. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte të ndërtimit,*
16. *Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e kompensimit për një (1) anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona,*
17. *Emërimi i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,*
18. *Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të autobusëve në Prishtinë për vitin 2017,*
19. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,*
20. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,*
21. *Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017,*
22. *Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017,*
23. *Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,*
24. *Kërkesa e GP të PSD për caktimin e kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë,*
25. *Kërkesa e GP të PSD-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike,*
26. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,*
27. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë,*
28. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,*
29. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-038 për shërbimet postare,*
30. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
31. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
32. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë,*
33. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, mbështetur edhe nga 7 deputetët nënshkrues nga GP i AAK-së, në lidhje me shtesat e fëmijëve.*

4. Përgatitjet për seancë plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e përfaqësueseve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet të enjten, më 1 nëntor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për referendum,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte të ndërtimit,
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e kompensimit për një (1) anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona,
14. Emërimi i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë për vitin 2017,
16. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
18. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017,
19. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017,
20. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,
21. Kërkesa e GP të PSD për caktimin e kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë,
22. Kërkesa e GP të PSD për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

5. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Propozimi i deputetit Milaim Zeka, mbështetur edhe nga 5 deputetë për formimin e Komisionit Hetimor në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala

Kryesia propozimin e lartshënuar e radhiti në rend dite për seancën plenare më 1 nëntor 2018, si dhe nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të PDK-së, LVV-së, AAK-së, Listës serbe, Nismës Socialdemokrate dhe “6+” që para seancës plenare më 1 nëntor 2018 t’i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas propozimit të deputetit Milaim Zeka, mbështetur edhe nga 5 deputetë të tjerë, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala.

2. Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë: grupet parlamentare të LDK-së, të LVV-së dhe PSD-së propozojnë pesë (5) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë kryesuesin, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nismës Socialdemokrate dhe “6+” propozojnë gjashtë (6) anëtarë, në mesin e tyre propozojnë zëvendëskryesuesin, sipas propozuesit.

2. Kërkesa e GP të PSD-së për ndarjen e kryesimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Kryetari i GP të PSD-së, Dardan Sejdiu, e arsyetoi kërkesën e lartshënuar, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesia kërkesën e lartshënuar e radhiti në rend dite për seancën plenare më 1 nëntor 2018.

3. Propozimi i GP të LVV-së për emërimin e një anëtari në Forumin për Transparencë Parlamentare

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Deputetja Fitore Pacolli-Dalipi, nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje, emërohet anëtare në Forumin për Transparencë Parlamentare.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Spanjë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Naser Rugova dhe Armend Zemaj, u lejohet udhëtimi zyrtar në Spanjë nga 18 - 20 nëntor 2018.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan kryetari i Kuvendit, z. Veseli dhe përfaqësuesi i GP-të LDK-së, z. Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

5. Kërkesa e deputetit Elmi Reçica për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Elmi Reçica, i lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 3 - 7 dhjetor 2018

Por, në rast se gjatë ditëve të lartshënuara Kuvendi do të mbajë seancë plenare, udhëtimi do të anulohet.

Në lidhje me kërkesat për udhëtime zyrtare jashtë vendit diskutuan: Dardan Sejdiu, kryetar i GP të PSD-së dhe Bilall Sherifi, kryetar i GP të Nismës Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

6. Pikat shtesë

1. Përzgjedhja e një firme audituese për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020

Kryesia, me rekomandim të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, mori këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Administrata e Kuvendit, përkatësisht Drejtoria për Prokurim për iniciimin e procedurave për përzgjedhjen e kompanisë për auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020.
2. Për përzgjedhjen e firmës audituese, Drejtoria e Prokurimit duhet ta njoftojë me raport me shkrim Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike,
3. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, pas përfundimit të procesit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit, pas secilit vit, e njofton Kryesinë e Kuvendit.

2. Kërkesa e deputetit Milaim Zeka për lejimin e udhëtimit zyrtar në Dubai

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Milaim Zeka, i lejohet udhëtimi zyrtar në Dubai nga 2 - 6 nëntor 2018.

Por, në rast se gjatë ditëve të lartshënuara Kuvendi do të mbajë seancë plenare, udhëtimi do të anulohet.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë të Delegacionit të Grupit Parlamentar të Miqësisë Kosovë-Emirate të Bashkuara Arabe në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Grupit të Miqësisë Kosovë-Emirate të Bashkuara Arabe në Kuvendin e Republikës së Kosovës i lejohet realizimi i udhëtimit zyrtar në Podgoricë (Mal të Zi) gjatë muajit nëntor 2018.
2. Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë udhëtim zyrtar nga pika një (1) e këtij vendimi duhet të jetë në përbërje: tre (3) anëtarë nga pozita dhe dy (2) anëtarë nga opozita.

4. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për darkën e shtruar nga delegacioni i Kuvendit në vizitën zyrtare në Vjenë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Elmi Reçica, për kompensimin e shpenzimeve në shumën prej 397.30 eurosh për darkën zyrtare të shtruar më 12 tetor 2018 nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës gjatë vizitës zyrtare të realizuar në Vjenë (Austri) nga 10 - 13 tetor 2018.

* * *

Në fund, kryetari i GP të PSD-së, Dardan Sejdiu, i propozoi Kryesisë së Kuvendit që në rend dite për seancën plenare të radhës të hyjë edhe propozimi i GP të PSD-së për

zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kryesia, propozimin e lartshënuar e radhiti në rend dite për seancën plenare më 1 nëntor 2018.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale